



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 49
Prishtinë, më 7 korrik 2010
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302
Mbledhja filloi në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë: Rustem Mustafa, Eqrem Kryeziu, Shkumbin Demaliaj, Basri Musmurati, Zylfi Merxha, Luljeta Shehu dhe Radmila Vujoviq - anëtarë të Komisionit.

Munguan: Lulzim Zeneli dhe Suzana Novoberdaliu - anëtarë të Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Antigona Ibraj, Blerina Pula, Nuredin Ibishi dhe Afrim Hoti.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të **18. 06. 2010** dhe të **23. 06. 2010**.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit.
4. Shqyrtimi i Strategjisë së Sigurisë të Republikës së Kosovës.
5. Informatë nga Policia e Kosovës.
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës. Kërkoj nga deputetët të jenë më të përkushtuar ndaj detyrave të tyre si anëtarë të komisionit dhe të paraqiten me kohë në mbledhjet e komisionit.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të 18. 06. 2010 dhe të 23. 06. 2010

Procesverbalet e datës 18. 06. 2010 dhe 23.06.2010 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit.

Kryetari i Komisionit - Për shqyrtimin e këtij Projektligji e propozoj deputetin Basri Musmurati të jetë referues për këtë Projektligj. Ju ftoj të jepni kontribut me komente që ky Ligj të dalë sa më i kompletuar.

4. Shqyrtimi i Strategjisë së Sigurisë të Republikës së Kosovës

Kryetari i Komisionit - Komisioni ynë është caktuar si komision funksional për shqyrtimin e propozimstrategjisë së Sigurisë së Republikës së Kosovës. Pas shqyrtimit do ta paraqesim raportin me rekomandime në seancë plenare. Për këtë çështje e kam paraparë ta organizoj një konferencë më 19 ose më 20 të këtij muaji. Në Konferencë do të marrin pjesë organizatat ndërkombëtare dhe të gjithë aktorët që janë të ndërlidhur me Sektorin e Sigurisë, që kanë interesim të kontribuojnë për këtë Strategji. Deri më tani jam i kënaqur me dokumentin e Strategjisë dhe ju ftoj, si deputetë, ta jepni kontributin tuaj.

5. Informatë nga Policia e Kosovës

Kryetari i Komisionit – Jua bëj me dije se ka ardhur njoftimi nga Policia e Kosovës. Komisioni më 26. 05. 2010 e ka zhvilluar një takim në objektin e Policisë së Kosovës me drejtorin e Policisë së Kosovës. Si deputetë i kemi shtruar disa çështje, për të cilat kemi marrë raport të hollësishëm nga drejtori i Policisë. Po e përmend një pyetje në lidhje me edukimin e policëve, që është bërë në një universitet, që ka qenë i palicencuar. Kam kërkuar nga stafi të bëjë pyetje shtesë për këtë çështje, sepse në raport përgjigjja për të ka qenë e paqartë. Kjo çështje është me rëndësi, sepse është harxhuar fondi i buxhetit të Kosovës.

6. Të ndryshme

Shkumbin Demaliaj - Për Strategjinë e Sigurisë kemi kritika nga ministri i Punëve të Brendshme, si i vetmi subjekt politik, që është kundër kësaj Strategjie. Mirëpo ka pasur edhe reagime nga subjektet e tjera se Strategjia është e mangët.

Basri Musmurati - Mendoj se për ngjarjet që po ndodhin në Mitrovicë, është mirë që ne si komision, gjithmonë të kemi njoftime me shkrim, në mënyrë që të mbeten në dokumentacion.

Kryetari i Komisionit – Shumë shpejt do të kemi njoftimin me shkrim nga ministri i MPB-së. Jam i njoftuar për ngjarjet që po ndodhin në Veri të Kosovës, që nuk janë shqetësuese.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E hartoi:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetari i Komisionit

Rrustem Mustafa